



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-13538/21
Kaçanik, 24.05.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **V-të (Pestë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 24.05.2021. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të KK, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje ishin të 7 anëtarët: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, Hafize Sallahi dhe Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Nënkryetari i Komunës – Ylber Bajra, drejtorët e drejtorive komunale, Bahri Selimi, Festim Neziraj, Ramadush Osmani dhe Ukshin Qallaku, ndërsa nga zyrtarët ishte, Arbnora Kuka.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, prezentë në mbledhje janë 7 anëtarë-të gjithë, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e V-të (Pestë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2021, data 24 Maj, me këtë;

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Raporti Tremujor Financiar, për periudhën: Janar-Mars 2021;
3. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, për këmbimin e pronës komunale me atë private në Zonën Kadastrale në Ivajë; dhe
4. Propozim Vendimi për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 02167-3, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, me kulturë, Arë e klasës së 5, në emër të Faik Gjini.

Kryesuesi i Kuvendit, Drejtori i DAP, Festim Neziraj me herët e pati një kërkesë para se me ardhur këtu në mbledhje për një pikë të rendit të ditës për mbledhje të KK. Është fjala për emërtimin e rrugëve, por meqë janë vonuar pak në punimin e materialit, pasi edhe sot dhe nesër kishin pakëz punë. Me pajtimin e juaj, a mundem atë pikë me proceduar për KK, kërkoj mendimin e juaj.

z. Ekrem Kyçyku, Unë jam për me proceduar në kuvend atë pikë, pasi që afatet ligjore kanë kaluar me shqyrtuar në KPF. Unë mendoj të procedohet drejt në KK çështja e emërtimit të rrugëve lokale.

znj. Hafize Sallahi, Edhe unë jam e mendimit me proceduar në kuvend çështjen e emërimit të rrugëve, kjo ka qenë kërkesë e imja në KK.

z. Festim Neziraj, Ky proces ka filluar në fund të vitit 2019, kur është marrë vendimi i parë, tek tash është kryer krejt procesi-është implimentuar në gjeoportat, d.m.th. ky proces ka zgjatur gati 2 vjet. Tek tani ne e kemi dritën jeshile për me plotësuar atë vendim në bazë të raportit fillestar, por me kërkesën e anëtarëve të KK u patën hequr nga dy pika të propozim vendimit. Tani janë gati ato emërtime, është fjala për emërtime në f. Biçec dhe në qytet, këto janë vetëm çështje teknike.

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkoj nga drejtori i DAP- Festim Neziraj- njëherë edhe kryesues i komisionit për emërtimin e rrugëve me përgatitur materialin për emërtimin e rrugëve për mbledhje të KK. Nëse KK pajtohet me hyrë në rend pune kjo pikë, procedojmë me këtë pikë me miratimin e të gjithëve, sepse nëse një anëtar nuk pajtohet, nuk mundem me proceduar me këtë pikë, sepse është jashtë procedurave.

znj. Pranverë Loku- Zharku, Nëse materiali bëhet i gatshëm për KK, atëherë drejtori të procedon për KK këtë pikë. Kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit të shtrojmë në votim këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit, Nuk shkon me votim kjo çështje, së është jashtë procedurave.

z. Ekrem Kyçyku, Pyetje drejtorit të DAP, A është urgjente kjo pikë?

znj. Hafize Sallahi, Është pak sa urgjente kjo pikë. Unë kam kërkuar në mbledhjen e fundit të KK për emërtimin e disa rrugëve në Biçec, sepse janë duke bërë presion nga dy lagje për emërtim të rrugëve. Ne vet i patëm hequr nga aprovimi emërtimin e disa rrugëve në f. Biçec, për shkak të një mosmarrëveshjes. Banorët e fshatit nuk kanë faj, ata donë me pasur adresat e tyre. Kanë bërë kërkesë edhe vet, kanë ardhur edhe të unë dhe unë në KK e ngrita këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkoj të përgatitet lënda për KK, pastaj në KK diskutojmë. Atëherë, rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 4 pikëve.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së IV-të (Katërt) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë: 23.04.2021 /Lënda: 01Nr. 60//01-11129/21.

2. Raporti Tremujor Financiar, për periudhën: Janar-Mars 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, drejtori është prezentë në mbledhje, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Faleminderit kryesues, Unë e kam lexuar pak raportin. Ajo që me ra në sy është të tabela e shpenzimeve, me bëri përshtypje shpenzimet kapitale janë mbi 4 % realizimi i tyre, e që kjo shumë e mjeteve e shpenzuar është vogël. Edhe shpenzimet komunale janë të ulëta, me shifra nuk e mbaj mend, por diku mbi 1% Konsideroj se ka pasur mundësi me arritur një përqindje me e madhe e realizimit të shpenzimeve në këtë tre mujor në këto programe shpenzuese buxhetore.

z. Selim Reka, Raporti si raport është mirë i hartuar. Krahësuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, të shpenzimet shihet së qëndrojmë më mirë, sepse janë shpenzuar me tepër mjete sesa në vitin e kaluar të GQ, me përjashtim të grantit të arsimit i cili është shpenzuar me pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Të shpenzimi i të HVK sivjet shihet se kemi me pak mjete të shpenzuara sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Të grumbullimi i të HVK gati së është e njëjta shumë me një ngritje të vogël në raport me ato të vitit të kaluar, me çka jep shpresë ardhja e diasporës të ngrit të HVK në obligimet që i kanë pa kryer, dhe me u realizuar inkasimi i të HVK. Të shpenzimet, ngritje me e madhe është të shërbimet, për 50%. Të IK nuk ka ndonjë ngritje të madhe të shpenzimeve. Ulje të shpenzimeve ka të subvencionet dhe transferet, ndërkaq një gjë e mirë është që të kursimet ka ulje për 50% në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, si të uji, energjia elektrike, mbeturinat të gjitha shënojnë ulje për gati 50%.

z. Bahri Selimi-drejtor i DEFZH, Përshëndetje të nderuar, Raporti tre mujor është vlerësuar si i shkurtër, i përmbledhur për janar-mars 2021, periudhë kjo e cila është e zbehur për shkak të procedurave. Alokimi i mjeteve mungon në këtë periudhë, fillon me u shpenzuar me vonë, bile edhe shpenzimet të cilat janë bërë të IK janë pjesë e pagesave që janë realizuar me herët-të vitit të kaluar. Të shërbimet komunale i kemi pasur disa parapagime, që dallojnë tani në pagesa. Të HVK janë realizuar në formë të mirë, 26 % është realizimi, nga 2 mijë euro jemi minus nga viti i kaluar në masë monetare, mirëpo planifikimi sivjet është me i ulët, e që nëse shkojmë më këtë realizim, i bien së 100% kemi më i realizuar të HVK. Inkasim ka me tepër të TP, pastaj të urbanizmi. IK u vlerësuar së shpenzimet janë të ulëta, mirëpo nëse i krahasojmë me vitin e kaluar, shihet se kemi ngritje të shpenzimeve në këtë program buxhetor, mirëpo periudha është e zbehtë për shkak së nuk mund të zhvillohen procedurat në këtë periudhë për shkak të kohës. Unë jam munduar me i plasuar në tabela shpenzimet, mirëpo meqë nuk ka pasur shumë, raporti del pak me i shkurtër. Të arsimit, është numri i madh i punëtorëve, më së shumti ka shpenzime të pagat, 146.000€ ka qenë granti i arsimit me tepër i shpenzuar, mundemi me analizuar nëse kam për KK. Të HVK vërtetë nuk kemi shumë të shpenzuar buxhet sivjet. Edhe bartja e të HVK nga viti 2020 nuk është bërë ende, miratimi ka ndodhë në muajin e 4 nga KK, por kësaj herë na i ka vonuar ministria. Keni mundur me vërejtje shtyllat buxhetore, që buxheti i miratuar në këtë program buxhetor është i njëjtë me buxhetin e tanishëm, realizimi është 17.86% për këtë periudhë, 6.67% është më i lartë sesa periudha e njëjtë e vitit paraprak, 26% janë të HVK të realizuara. Është një ecuri e mirë e nisjes së vitit buxhetor.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky raport t'i shkoj KK në procedurë për diskutim ? Rezultati i votimit ishte njëzëri Për.

Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF, **Deatoj Raportin Tremujor Financiar, për periudhën: Janar-Mars 2021 dhe i njëjti i kalohet Kuvendit të komunës në procedurë për debatim.**

3. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, për këmbimin e pronës komunale me atë private në Zonën Kadastrale në Ivajë;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme fjalën e ka drejtori i DUKMM, Ukshin Qallaku.

z. Ukshin Qallaku, Përshëndetje për të gjithë, ju njoftoj së rruga që është ndërtuar para shumë viteve që lidhë fshatrat: Gajre, Ivajë, Shtrazë, një pjesë e rrugës është në pronën e Mefail Rexha. Është gjeoprtali ku shihet pjesa e parcelave që iu kanë marrë kur është bërë zgjerimi i rrugës që është pronë e tij, mirëpo është një shtëpi e ndërtuar në një rrugë e cila këtu figuron së është rrugë publike, ndërkaq nuk është shfrytëzuar asnjëherë. Tash këtë rrugë ne e kemi devijuar nëpër pronë të tij, se qysh me ia prishur shtëpinë, kështu rreth shtëpisë i merret parcela e lidhim me rrugën kryesore, duke ia këmbyer me pronën publike të komunës. Këmbimi i vjen 1:1. Kjo rrugë figuron në fakt së është e pashfrytëzueshme.

Kryesuesi i Kuvendit, E hapi diskutimin për këtë pikë;

z. Nexhat Loku, Kërkoj sqarime të nevojshme lidhur me pronën që shpronësohet me qëllim këmbimi me pronën e komunës, ndërkaq për shtëpinë në atë pjesë, ai e ka blerë atë shtëpi.

znj. Hafize Sallahi, Këtu është problemi Nexhat, së Mefail Rexha nuk mundet me bartë mbi veti pronën për pa e rregulluar dokumentacionin lidhur me atë pronë. Nuk ka lidhje a e ka blerë shtëpinë apo jo, ne duhet t'i bëjmë zgjidhje me bartë pronën mbi veti, sepse nuk mundemi me ia prishur shtëpinë.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky Propozim Vendim t'i shkoj KK në procedurë për shqyrtim dhe aprovim ? Për ishin të gjithë anëtarët e KPF, kështu që konstatohet së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, për këmbimin e pronës komunale me atë private në Zonën Kadastrale në Ivajë; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendimi për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 02167-3, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, me kulturë, Arë e klasës së 5, në emër të Faik Gjini.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF mori këtë:

VENDIM

Me të cilin MIRATOHET Propozim Vendimi i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit 06-350/02-9899/21 -Për Lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të FAIK GJINI nga f. Vatë. në sipërfaqe 250m², në PK 02167-3 në sipërfaqe të përgjithshme 3200m², ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë, Arë e klasës së 5 (Pestë), pronë private në emër të Faik (Islam) Gjini sipas Certifikatës me numër të lëndës: 06-941/01-9889/21 të lëshuar nga Zyra Kadastrale me 02.04.2021.

Kryesuesi i Kuvendit, Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora: 11:25. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KPF.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 28 Maj 2021 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

M Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

K Mërseli